



Kuvendi i Komunës Klinë

01Nr. 06-3885 /2025

Datë: 26.03 /2025

PËR: Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve
Znj. Bora Duli Ud. Drejtoresh e Departamentit Ligjor

NGA: Kuvendi i Komunës së Klinës
Kryesuesi i Kuvendit Fadil Gashi



LËNDA: Shkresë informuese lidhur me rishqyrtimin e Vendimit 01Nr.06-3885/2025

Të nderuar/a, pas shqyrtimit të kërkesës tuaj, për rishqyrtim të Vendimit **01Nr.06-3885/2025** për ndryshim-plotësim të vendimit **01Nr.06-31721/2020** i cili është në fuqi nga viti **2020** për pagesën e shujtave për të gjithë të punësuarit në Administratën e Komunës së Klinës, i miratuar me datë: **31.01.2025**, i dërguar për shqyrtim të ligjshmerisë në MAPL me datë: **06.02.2025** dhe i kthyer për rishqyrtim nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve me datë: **24.02.2025**.

Kuvendi i Komunës së Klinës, në seancën e **III-të** të rregullt të mbajtur me datë: **21.03.2025** ka rishqyrtuar vendimin e lartpërmendur sipas kërkesës së Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve.

Pas rishqyrtimit të vendimit, Kuvendi ka realizuar një analizë të plotë dhe të detajuar lidhur me argumentet dhe faktet e paraqitura nga MFPT dhe më pas Kuvendi i Komunës së Klinës bazuar në Rregullorën e Punës së Kuvendit, dispozitat e Rregullores (MAPL) **nr.02/2021**, për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve të Komunës, Nenin **4** të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative **05/L-031** si dhe Nenit **81** paragrafi **81.4** i Ligjit për Vetëqeverisje Lokale **Nr03/L-040**, pas shqyrtimit të të gjitha elementeve të lartpërmendura kemi arritur në përfundim se vendimi i **01Nr.06-3885/2025** për ndryshim-plotësim të vendimit **01Nr.06-31721/2020** për pagesën e shujtave për të gjithë të punësuarit në Administratën e Komunës së Klinës, i miratuar me datë: **31.01.2025**, mbetet i pa ndryshuar me **24 vota PËR, 0 Kundër dhe 0 Abstenim**.

Për më shumë, Kuvendi i Komunës së Klinës është i gatshëm t'ju ofrojmë sqarime të mëtejshme

Me respekt,